



MBAHEN NË TIRANË “DITA ARBËRESHE” DHE “SAMITI III I DIASPORËS”

MEPJ Igli Hasani e cilësoi eventin e “Ditës Arbëreshe” si një moment domethënës në marrëdhëniet mes shtetit shqiptar dhe komuniteteve arbëreshe, teksa ritheksoi mbështetjen e MEPJ dhe qeverisë shqiptare ndaj këtyre komuniteteve. Në Samitin III të Diasporës, Ministri Hasani theksoi rolin e pazë vendësueshëm të diasporës në avancimin e kauzës kombëtare, teksa u shpreh se samiti shërben si një mundësi për të eksploruar ide e forma konkrete bashkëpunimi.



NATO, HASANI: NJË ALEANCË E FORTË, GUR THEMELI I SIGURISË SË PËRBASHKËT

Në Konferencën Vjetore të Mbrojtjes Kibernetike të NATO-s, MEPJ Igli Hasani theksoi rëndësinë e rritjes së shkëmbimit të inteligjencës dhe nxitjes së bashkëpunimit të fortë brenda aleatëve, për parandalimin e kërcënimeve kibernetike. Gjatë takimit të MPJ-ve të NATO-s në Bruksel, MEPJ Igli Hasani tha se Shqipëria do të vijojë të luajë rol parësor në paqen e sigurinë mes të gjitha vendeve fqinje të rajonit, ndërsa vlerësoi bashkëpunimin mes KFOR, EULEX dhe policisë së Kosovës.



SHQIPËRIA ZGJIDHET ANËTARE E BORDIT EKZEKUTIV TË UNESCO-S PËR PERIUDHËN 2023-2027

Ministri Hasani theksoi se Shqipëria do të bashkëpunojë ngushtë me të gjithë anëtarët e Bordit, në frymën e dialogut dhe konsensusit. Në Konferencën e Përgjithshme të UNESCO-s, Ministri Hasani e cilësoi UNESCO-n si një aktor të rëndësishëm në bashkëpunimin shumëpalësh, teksa nënvizoi se multilateralizmi aktiv dhe i rigjallëruar mbetet e vetmja rrugë për të vazhduar përpara.



MINISTERIALI I OSBE, MINISTRI HASANI: EVROPA E SIGURTË VETËM ME NJOHJEN E PAVARËSISË SË KOSOVËS

Në takimin e 30-të të Këshillit Ministror të OSBE-së, MEPJ Igli Hasani dënoi agresionin rus në Ukrainë, teksa theksoi se Rusia po kërkon të nxisë telashe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke dobësuar kështu edhe OSBE-në. Kryediplomati shqiptar u shpreh se Shqipëria po bën çmos për t’iu kundërvënë këtyre kërcënimeve, por sipas tij nevojitet një përpjekje e bashkërenduar nga të gjithë miqtë dhe partnerët për të neutralizuar këto përpjekje.



BRUKSEL, MINISTRI HASANI: SHQIPËRIA E PALËKUNDUR NË RRUGËN E SAJ DREJT BE

MEPJ Igli Hasani ka marrë pjesë në takimin e Ministrave të Jashtëm të vendeve anëtare të BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor, që u mbajt në Bruksel. Ministri Hasani konfirmoi përkushtimin e palëkundur të Shqipërisë në rrugëtimin e saj evropian, teksa nënvizoi se qeveria shqiptare po bën çmos për të përmbushur objektivat e vendosura nga BE.



MINISTRI HASANI VIZITË DY-DITORE NË VIENË: AUSTRIA MBËSHTET RRUGËTIMIN E SHQIPËRISË DREJT BE

MEPJ Igli Hasani zhvilloi një vizitë zyrtare dy ditore në Vienë të Austrisë, ku zhvilloi disa takime dypalëshe me zyrtarë të lartë si: MPJ i Austrisë, Alexander Schallenberg; Sekretaren e Përgjithshme të OSBE, Helga Schmidt, etj. Në fokus të takimeve ishte rrugëtimi evropian i Shqipërisë dhe thellimi i mëtejshëm i bashkëpunimit bilateral në fushën e sigurisë dhe ekonomisë. Ministri Hasani vlerësoi angazhimin e Austrisë dhe OSBE për zhvillimin dhe stabilitetin e BP.



DY FAMILJE SHQIPTARE NXIRREN ME SUKSES NGA TERRITORI I GAZËS

Falë punës koordinuese të MEPJ me autoritet e Izraelit dhe Egjiptit, dy familje shqiptare, gjithsej prej 11 anëtarësh, kanë dalë me sukses nga territori i Gazës, për t’u kthyer më pas në Shqipëri.



MINISTRI HASANI DHE MINISTRJA ODOBESCU NËNSHKRUAJNË PLANIN E VEPRIMIT PËR BASHKËPUNIM PËR VITET 2024-2025

Plani i Veprimit synon rritjen e bashkëpunimit mes dy vendeve në 4 fusha kryesore: Rritja e dialogut politik dhe shkëmbimet mes dy ministrave; Integrimi në BE; Bashkëpunimi për NATO-n dhe politikën e sigurisë dhe rritja e bashkëpunimit në fushën e çështjeve konsullore dhe menaxhimit të krizave.



LEHTËSOHET LËVIZJA E SHETASVE SHQIPTARË NGA SHQIPËRIA DREJT SHBA DHE ANASJELLTAS

Në dakordësi dhe bashkëpunim me Departamentin e Shtetit, tani shtetasit shqiptarë mund të udhëtojnë drejt SHBA edhe nëse pasaporta e tyre skadon në 6 muajt e fundit përpara udhëtimit. Vendimi e fut Shqipërinë në të ashtëquajturin “Grupi i Klubit 6 mujor”.